



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1822/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Gjakova”, SH.A., me seli në Gjakovë, rruga “..”, nr..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat R.G. nga Gjakova, kundër debitorit “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, rruga “Nëna Terezë” p.n përfaqësuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.223/22 të datës 02.03.2021, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 17.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.223/22 të datës 02.03.2021, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me Aktvendim E.nr.609/10 të datës 18.10.2010 ka lejuar përmbartimin, Gjykata Themelore Gjakovë me Konkluzion të datës 28.04.2022 lëndën përmbartimore e ka transferuar tek Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë për vazhdimin e procedurës, ndërsa Përmbartuesi Privat me Konkluzion P.nr. 223/22 të datës 10.05.2022 i ka njoftuar palët për vazhdimin e procedurës përmbartimore në këtë lëndë.

Kreditori me parashtresën e datës 12.05.2022 e ka precizuar propozimin për përmbartim sa i përket shumës.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas precizimit të propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Gjakova”, SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.223/22 të datës 02.03.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave të viteve

2006-2010, ku e ka urdhëruar debitorin “Prokuroria Komunale - Gjakovë”, që brenda afatit prej 8 ditësh pas pranimit të aktvendimit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 533.15 €, me kamatë ligjore prej 3.5% nga dita e parashtrimit të propozimit për përmbarim e deri në ditën e pagesës si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, në të kundërtën përmbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit në NLB Bank nr....., ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përmbarimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se në periudhën 2006-2010 nuk ka qenë në fuqi Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës prandaj përgjegjëse për pagesa në këtë periudhë ka qenë Ministria e Drejtësisë. Tutje thekson se urdhri është i metë pasi që nuk përmban pjesën e këshillës juridike e drejtë e cila garantohet me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Ne vazhdim ka deklaruar se nuk janë ndjekur procedurat sipas Rregullores Financiare Nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike respektivisht kreditori nuk ka ndjekur rrugët ligjore për të arkëtuar të hyrat nga faturat. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta refuzoj urdhrin dhe precizimin e Urdhrit Përmbarimor P.nr.223/22.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se prapësimi duhet të hedhet poshtë si i pa afatshëm si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit rreth mungesës të legjitimitetit pasiv nuk qëndrojnë sepse si pasardhëse juridike “Prokuroria Komunale e Gjakovës” i bart të gjitha obligimet lidhur me shpenzimet e krijuara ndaj kreditorit. Tutje thekson se parashkrimi në këtë rast nuk vjen në konsideratë pasi që debitori është person juridik dhe shpenzimet komunale parashkruhen në periudhë 3 vjeçare. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta refuzoj në tërësi prapësimin si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e bashkangjitura në propozim për përmbarim, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet - faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret faturat objekt i përmbarimit janë kopje, në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo të vërtetuara tek organi kompetent.

Gjykata konstaton se faturat që gjenden në shkresat e lëndës nuk janë origjinale apo të vërtetuara tek organi kompetent, siç përcaktohet në dispozitën e nenit 37 të LPP-së, dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe kreditorit të paraqitur në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbarimore,

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e së cilës Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë

edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1822/22, datë 17.08.2023

Gjyqtar

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.